

### Njoftim nga AMF për qytetarët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-nëntor 2019
- Tregtimi i Titujve në Bursën ALSE për vitin 2019

### Zhvillime të tjera

- Bashkëpunim i AMF-së me FMA Austri në sektorin e sigurimeve

### Edukimi i Konsumatorit

- IAIS – zhvillimet kryesore gjatë 2019

### Botime Profesionale

- Global Risk Regulator, volumni 17, dhjetor 2019

### Lajme Ndërkombëtare

- Greqi
- Hungari
- Kroaci
- Republika Çeke
- Rumani
- Serbi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Njoftim nga AMF për qytetarët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dëshiron të informojë të gjithë qytetarët e prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019, që kanë një kontratë për sigurimin e banesës apo pronës nga katastrofat natyrore, si tërmetet, zjarri, përmytjet, që të kontaktojnë menjëherë shoqërinë e sigurimit për të njoftuar për dëmtimet e ndodhura.

Pasi të keni njoftuar zyrtarisht ndodhjen e ngjarjes së siguar, një ekspert i shoqërisë së sigurimit do paraqitet në banesën/pronën e dëmtuar për të evidentuar dëmet. Bëni kujdes që njoftimi i shoqërisë së sigurimit të kryhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën e sigurimit.

Ju mund të kontaktoni shoqërinë e sigurimit të adresën e selisë qendrore apo në zyrat që ajo ka në rrethin ku ndodheni për të njoftuar dëmtimet e ndodhura në banesën apo pronën Tuaj, si dhe për t'u informuar me detaje në lidhje me procedurat dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim.

Çdo shoqëri sigurimi ka një faqe zyrtare interneti, ku ka të publikuar adresat dhe mënyrat e kontaktit. Lista me shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë me adresat përkatëse gjendet edhe në faqen e internetit të AMF-së [https://amf.gov.al/ts\\_shoqeri\\_sigurimi.asp](https://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp)

Nëse keni marrë një kredi bankare Ju mund të kontaktoni dhe bankën për t'u informuar nëse keni siguruar banesën apo pronën Tuaj, si dhe për të kërkuar asistencën që iu nevojitet.

—○○○—  
Autoriteti i Mbikëqyrjes  
Financiare dëshiron të  
informojë të gjithë  
qytetarët e prekur nga  
tërmeti i datës  
26.11.2019, që kanë një  
kontratë për sigurimin e  
banesës apo pronës nga  
katastrofat natyrore, të  
kontaktojnë menjëherë  
shoqërinë e sigurimit për  
të njoftuar për dëmtimet  
e ndodhura.



# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-nëntor 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-nëntor kapën vlerën mbi 15,635 milionë lekë, ose 3.20% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2018. Gjatë periudhës janar-nëntor 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,211,089 me një rritje 3.14% krahasuar me periudhën janar-nëntor 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.76% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.83% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.41%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.13% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.87% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,488 milionë lekë, ose 11.13% më pak se në periudhën janar-nëntor 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-nëntor kapën vlerën mbi 15,635 milionë lekë, ose 3.20% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2018.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2019 (Në %)



## Tregtimi i titujve në Bursën ALSE për vitin 2019

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë vitit 2019, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 327,201,585 lekë dhe Obligacione Thesari në vlerën prej 2,136,495,920 lekë.

Duke analizuar volumin dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij viti, kanë dominuar transaksionet e ekzekutuara gjatë orarit zyrtar, ndërsa si numër transaksionesh më shumë ka patur jashtë orarit zyrtar të Bursës.

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për vitin 2019, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në vlerë dhe numër transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve, ndërsa në volum kanë dominuar transaksionet ndërmjet Anëtarëve të Bursës ALSE (Shoqërive Komisionere Banka dhe jo-Banka.)

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R.Sh. në Bursën ALSE		
Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (Në mijë Lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
Për Anëtarët	310,868	263,881
Për Klientët	16,334	1,872,615
Individë	14,353	141,895
Persona Juridikë	1,982	1,730,720
<b>TOTAL</b>	<b>327,202</b>	<b>2,136,496</b>

# ZHVILLIME TË TJERA

## Bashkëpunim i AMF-së me FMA Austri në sektorin e sigurimeve

Specialistë dhe ekspertë nga Departamenti i Sigurimeve të AMF-së morën pjesë në inspektim dhe takime të përbashkëta me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA). Takimet u zhvilluan në Vjenë, në datat 2-5 dhjetor 2019. Inspektimi u realizua pranë zyrave qendrore të shoqërisë UNIQA International AG. Në takimet e përbashkëta ishin të pranishëm drejtues dhe specialistë të Drejtorisë së Inspektimit në vend të autoritetit austriak FMA.

Përvoja e dhënë nga ekspertët e UNIQA International AG lidhej edhe me tematika të inspektimit në grup. Të pranishëm në takim ishin drejtuesit kryesorë të UNIQA International AG. Prezantime u bënë edhe nga Z.Wolfgang Kindl, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i UNIQA International AG, Sekretari i Përgjithshëm Z. Gerald Müller, si edhe drejtues të tjerë René Knapp, Manfred Schuster, Andreas Magenschab, Andreas Rauter.

Disa nga tematikat kryesore të diskutuara lidheshin me:

- Strategjia dhe vizioni i UNIQA International AG për Sigal Uniqa Grup Austria sh.a.;
- Strategjia e investimit i UNIQA International AG për Sigal Uniqa Group Austria sh.a.;
- Funkzioni aktuaristikës i UNIQA International AG lidhur me Sigal Uniqa Group Austria sh.a.;
- Funkzioni auditit të brendshëm i UNIQA International AG lidhur me Sigal UNIQA Group Austria sh.a.;
- Funkzioni i përputhshmërisë i UNIQA Internacional AG lidhur me Sigal UNIQA Group Austria sh.a.;
- Funkzioni i risigurimit i UNIQA International AG lidhur me Sigal UNIQA Group Austria sh.a.;
- Funkzioni kontrollit i UNIQA International AG lidhur me Sigal UNIQA Group Austria sh.a. ku u prezantua funksioni i kontrollit të brendshëm, organizimin në nivel rajonal si dhe zhvillimet më të fundit lidhur me implementimin e sistemit SAP.

Specialistë dhe ekspertë nga Departamenti i Sigurimeve të AMF-së morën pjesë në inspektim dhe takime të përbashkëta me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA).

## IAIS – zhvillimet kryesore gjatë 2019

Fjala e Jonathan Dixon, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), mbajtur në forumin aziatik të sigurimeve “*Fintech Developments: Disruption or Dividends?*” zhvilluar në Hong Kong, 10 dhjetor 2019.

(Pjesa e parë - marrë me shkurtime dhe redaktime)

2019 ishte një vit domethënës për IAIS. Ne festuam përvjetorin tonë të 25-të. Ndër vite IAIS është zhvilluar duke u rritur nga një organizëm joformal i bashkimit të mbikëqyrësve të sigurimeve, duke u shndërruar në përcaktuesin e standardeve globale për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe pjesë integrale e përpjekjeve më të gjera për ta bërë sistemin financiar global më elastik. Ishte një testament i vërtetë për angazhimin tonë për të vendosur standarde të fuqishme globale, ne ishim në gjendje të ndërmerrnim kaq shumë hapa domethënës përpara në lidhje me kontributin e IAIS në axhendën e reformës pas krizës financiare.

**E para** nga këto arritje është rishikimi në thelb i Parimeve Themelore të Sigurimeve (Insurance Core Principles, ICP) – të cilat janë dokumenti i referencës për mbikëqyrësit e sigurimeve në të gjithë botën. Kjo sjell realizimin e rishikimit shumëvjeçar dhe të gjerë të materialit tonë mbikëqyrës. IAIS tashmë të krijuar një seri standardesh të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që pasqyrojnë të gjitha zhvillimet kryesore të tregut dhe mbikëqyrjes që ndikojnë sektorin e sigurimeve.

Arritja **e dytë** thelbësore ishte miratimi i ComFrame - korniza e parë globale për mbikëqyrjen efektive dhe globalisht të qëndrueshme të Grupeve Aktive Ndërkombëtare të Sigurimeve (IAIGs). Si përgjigje ndaj një sektori të gjithnjë e më të globalizuar të sigurimeve, tani kemi - për herë të parë - një seri kërkesash mbikëqyrëse të dakordësuara globalisht, të përshtatura për veprimtarinë dhe madhësinë e këtyre grupeve globale. Kjo do të ndihmojë mbikëqyrësit të adresojnë rreziqet në të gjithë grupin dhe të shmangin boshllëqet ndërkufitare të mbikëqyrjes.

**Së treti**, IAIS miratoi Kuadrin Holistik për vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut sistematik në sektorin global të sigurimeve. Kjo përfshin një sërë masash të politikës mbikëqyrëse që kanë një fokus të veçantë në kujdesin në nivel makro, si dhe një ushtrim vjetor të monitorimit global, nga IAIS, i cili është krijuar për të ndihmuar në zbulimin e hershëm të rrezikut të mundshëm sistematik dhe një diskutim kolektiv midis mbikëqyrësve globalë për t’ju përgjigjur në mënyrë të koordinuar këtyre risqeve.

**E fundit**, por jo për nga rëndësia, në takimin vjetor në nëntor 2019 në Abu Dhabi u bë gjithashtu një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin e një Standardi Global të Kapitalit të Sigurimeve (ICS), komponentit sasior të ComFrame.

○ ○ ○

Ndër vite IAIS është zhvilluar duke u rritur nga një organizëm joformal i bashkimit të mbikëqyrësve të sigurimeve, duke u shndërruar në përcaktuesin e standardeve globale për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe pjesë integrale e përpjekjeve më të gjera për ta bërë sistemin financiar global më elastik.

○ ○ ○



Siç mund ta kuptoni, viti 2019 ishte një vit i ngjeshur, me arritje të mëdha. Sidoqoftë, nuk është koha që IAIS të ngadalësojë ritmin. Tani, jo vetëm që duhet të zhvendosim fokusin në zbatimin e këtyre reformave të rëndësishme të dakorduara, por duhet të shikojmë edhe në horizontin tjetër.



ICS synon të mbështesë një gjuhë të përbashkët diskutimi e mbikëqyrëse mbi aftësinë paguese të grupeve të Grupeve Aktive Ndërkombëtare të Sigurimeve dhe të përmirësojë konvergjencën globale midis standardeve të kapitalit në grup. Zhvillimi i Standardit Global të Kapitalit (ICS) ka qenë një udhëtim shumëvjeçar, duke zhvilluar gjashtë testimit në terren çdo vit që prej vitit 2013.

Me marrëveshjet e arritura muajin e kaluar, Versioni 2.0 ICS do të hyjë në një "periudhë monitorimi" pesëvjeçare, gjatë së cilës do të përdoret për raportim konfidencial te mbikëqyrësit në të gjithë grupin, do të diskutohet në kolegjet mbikëqyrëse dhe do të analizohet më tej nga IAIS. Reagimet e palëve të interesit, veçanërisht nga grupet e sigurimeve pjesëmarrëse, do të mbeten kritike gjatë kësaj periudhe. Kjo, së bashku me reagimet nga mbikëqyrësit, analiza të mëtejshme teknike dhe një studim i ndikimit ekonomik, do të na ndihmojnë të përpunojmë dhe përmirësojmë më tej Standardin Global të Kapitalit (ICS) para zbatimit të tij si një standard ndërkombëtar.

Siç mund ta kuptoni, viti 2019 ishte një vit i ngjeshur, me arritje të mëdha. Sidoqoftë, nuk është koha që IAIS të ngadalësojë ritmin. Tani, jo vetëm që duhet të zhvendosim fokusin në zbatimin e këtyre reformave të rëndësishme të dakorduara, por duhet të shikojmë edhe në horizontin tjetër. Në fillim të këtij viti, ne vendosëm mbi vizionin tonë për 5 vitet e ardhshme, me miratimin e Planit tonë Strategjik 2020-2024. Ne kemi identifikuar prirjet dhe zhvillime të rëndësishme - duke përfshirë, si shumë të rëndësishëm FinTech, por edhe rrezikun kibernetik, rrezikun e klimës, rëndësinë e sjelljes dhe kulturës, dhe sfidën e zhvillimit të qëndrueshëm - të gjitha këto kanë potencialin për riformatimin e sektorit të sigurimeve në të cilin ne do të operojnë në vitet e ardhshme.

## GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, dhjetor 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- FCA diskuton mbi sistemet e rregullimit pas Brexit-it në Mbretërinë e Bashkuar  
(*FCA ponders UK rules post-Brexit*)
- Autoritetet e BE-së janë të hapura për të konsideruar ndryshimet teknike në Direktivën MiFID II  
(*EU authorities open to considering technical tweaks to MiFID II*)
- Gjermania vendos piketat e rëndësishme, lidhur me Bashkimin Bankar Evropian  
(*Germany paves way for completing European banking union*)





## **Greqi**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Greqi u rritën me 7.8% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 3 miliardë euro.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 15.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.45 miliardë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 1.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.55 miliardë euro.

## **Hungari**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Hungari u rritën me 10.97% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 862.2 miliardë forinta (HUF, monedha vendase) ose 2.66 miliardë euro. Dëmet e paguara bruto arritën në 312.95 miliardë forinta për sigurimin e Jetës dhe 198.45 miliardë forinta për sigurimin e Jo-Jetës.

## **Kroaci**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fillim të dhjetorit 2019, Byroja Kroate e Sigurimeve dhe Qendra Kroate e Mjeteve lajmëruan nisjen e një projekti dixhitalizimi për sigurimin MTPL. Projekti parashikon krijimin e një regjistri virtual për të gjitha siguracionet MTPL të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit për mjetet me targa kroate. Pasi policëmbajtësi të nënshkruajë elektronikisht kontratën, shoqëria e sigurimit ia dërgon automatikisht të dhënat e mjetit brenda pak minutash një databaze kombëtare, të administruar nga Qendra Kroate e Mjeteve.

Informacioni është i aksesueshëm nga departamenti i sigurisë rrugore pranë Ministrisë së Brendshme dhe inspektorët e mjeteve. Edhe policëmbajtësit do të kenë mundësi të kontrollojnë vlefshmërinë e siguracioneve MTPL, duke përdorur platformën.

## Republika Çeke

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Republikën Çeke u rritën me 5.64% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 102.86 miliardë koruna (CZK, monedha vendase) ose 3.98 miliardë euro.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 3.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 34 miliardë koruna. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 6.75%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 68.9 miliardë koruna.

## Rumani

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Rumani u rritën me 6.7% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.7 miliardë euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga siguruesit u rritën me 13%, duke arritur në 1.04 miliardë euro, më së shumti për shkak të dëmeve në sigurimin MTPL. Struktura e tregut qëndroi thajse e pandryshuar. Sigurimi i Jetës zë 20.48% të tregut, sigurimi motorik 57%, ndërsa sigurimi i pronës 12%.

## Serbi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Serbi u rritën me 5.9% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 79 miliardë dinarë (RSD, monedha vendase) ose 672 milionë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 6.4%, duke arritur në 61.3 miliardë dinarë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 4.5%, duke arritur në 17.7 miliardë dinarë.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)